

**VENDIM**  
**PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESVE**

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe nenit 15, të rregullores nr. 3152/5, datë 11.12.2018, “Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe për procesin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Komisioni i Votimit, me përbërje:

Alma Muça kryetare;

Thoma Jano anëtar;

Alfred Progonati anëtar,

pas administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

**VËREN:**

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e një anëtari prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave të vlefshme, renditen në mënyrën si vijon:

I. Për anëtar prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

z. Etien Kapo 83 vota

znj. Ledina Riza 115 vota

II. Për anëtar prokuror në Këshillin Drejtues të Magjistraturës:

z. Albert Kuliçi 100 vota

z. Arqilea Koça 76 vota

znj. Elona Alvora 20 vota

**PËR KËTO ARSYE,**

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, dhe 247, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15, të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë fitues si anëtar prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;  
Znj. Ledina Riza
2. Të shpallë fitues si anëtar prokuror në Këshillin Drejtues të Magjistraturës:  
Z. Albert Kuliçi
3. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 25.10.2022 , ora 13:12

**KOMISIONI I VOTIMIT**  
**Kryetare: Alma Muça**  
**Anëtarë: Thoma Jano, Alfred Progonati**